

DATA 31.07.2025

KONTRATË SHITJE KUOTA KAPITALI

SHITËSI: Kevin Gaçi, i datëlindjes 09.03.1998, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me ID për identifikim me Nr J80309061G.

Dhe,

BLERËSI: Shoqëria AG.TCC shpk me NIPT L52227046H, me seli ne Tiranë, me administrator Z. Artan Gaçi.

Ekzistojnë këto kushte paraprake

Rezulton se shoqëria Melesin Distillery shpk, është person juridik shqiptar rregjistruar në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më datë 31.07.2025 dhe pajisur me numër identifikimi NUIS M57508001C, me kapital themeltar prej 100.000,00 (njëqindmijë) Lekë.

Ortaku i vetëm i shoqërisë: Kevin Gaçi

Shoqëria ka si objekt veprimtarie: Bar, restorant, hoteleri, shitje dhe distribucion me shumicë dhe pakicë të pijeve alkoolike.

Ortaku i vetëm, në datën 31.07.2025 ka vendosur transferimin nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë Melesin Distillery sh.p.k, në favor të shoqërise AG.TCC shpk.

Neni 1

Objekti i Kontratës

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate është shitja e 100 % të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë të zotëruara nga Z. Kevin Gaçi në favor të shoqërise AG.TCC shpk.

Neni 2

Çmimi i shitjes

- 2.1 Palët, bien dakort që çmimi total i shitjes së këtyre kuotave do të jetë 100.000,00 ALL (njëqindmijë) Lekë
- 2.3 Pagimi i çmimit të shitjes është kryer plotësisht nga blerësi, sot në datën e nënshkrimit të kësaj kontratë.

Neni 3

Kalimi i titullit të pronësisë

- 3.1 Kalimi i titullit të pronësisë dhe fitimi i pronësisë bëhet nga çasti i kalimit të kuotave dhe regjistrimi i dokumentacionit përkatës në QKB.

- 3.2 Një kopje e kësaj kontrate shitjeje do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, (QKB) në mënyrë që të bëhet kalimi i menjëhershëm i kuotave në pronësi të blerësit.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e shitësit

- 4.1 Shitësi mori përsipër, të njoftojë, garantojë dhe sigurojë Blerësin se deri në momentin e lidhjes dhe të nënshkrimit të Kontratës së mësipërme këto kuota:
- Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor,
 - Nuk janë të bllokuara për llogari të të tretëve,
 - Shitësi është pronar ligjor dhe nuk ka persona të tjerë të kenë pretendime në lidhje me këto kuota,
 - Dokumentacioni i bashkëngjitur kësaj Kontrate, është origjinal, ligjor dhe nuk është marrë në rrugë të kundraligjshme apo i fallsifikuar,
 - Nuk ka asnjë kontratë të lidhur më parë e cila të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi pronësinë mbi këto kuota kapitali,
 - Shitësi nuk ka detyrime të papaguara në favor të të tretëve .
- 4.2 Shitësi është i detyruar të paguajë detyrimet në shoqëri dhe ndaj shtetit deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje kuotash. Pas këtij momenti detyrimet e tjera mbulohen nga blerësi. Shpenzimet e tjera bëhen nga palët sipas parashikimeve të Kodit Civil.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit

- 5.1 Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, Blerësi do paguajë çdo lloj takse mbi kapitalin që ai zotëron në shoqëri, detyrimet ndaj të tretëve, shtetit etj...
- 5.2 Blerësi ka të drejtë që të sillet si pronar i ligjshëm mbi këto kuota nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 5.3 Kjo kontratë është e detyrueshme edhe për trashëgimtarët të palëve.

Neni 6

Zgjidhja e Kontratës

- 6.1 Palët nuk mund ta zgjidhin kontratën në mënyrë të njëanshme përveç kur kemi mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale.
- 6.2 Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në Kontratë në mënyrë të njëanshme. Për çdo problem që mund të lindë, apo ndryshim i domosdoshëm i kontratës i diktuar nga kushtet konkrete të vendit apo legjislacionit, palët do të informojnë njëri tjetrin në adresat

përkatëse me shkrim dhe vetëm pasi kanë rënë dakord mund të realizojnë ndryshime në kontratë.

Neni 7

Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 7.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

Neni 8

Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

- 8.1 Kjo Kontratë shitje, me objekt Shitje kuotash, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” .
- 8.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9

Njoftimet

- 9.1 Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim në adresat e përshkruar në këtë Kontratë duke pasur parasysh që të dërgohet sa më shpejt.

SHITËSI

KEVIN GAÇI

MELESTIN
DISTILLERY
M57508004C

BLERËSI

AG.TCC SHPK

ARTAN GAÇI

